VENDIM
Nr. 29, datë 30.1.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË REJ ENERGY SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, ME NR. 177, SERIA PV12K, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 120, DATË 29.8.2012

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; të nenit 15 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin për modifikimin e licencës së shoqërisë Rej Energy sh.p.k., përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Shoqëria Rej Energy sh.p.k., është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: Cemerica 1, me fuqi të instaluar 0.88 mw; Cemerica 2, me fuqi të instaluar 0.9 mw; Cemerica 3, me fuqi të instaluar 2.1 mw, me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 120, datë 29.8.2012.

Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria Rej Energy sh.p.k., në bazë të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", rezulton si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa "a", "Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës", plotësuar.
- Neni 15, pika 4, germa "b", "Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence", plotësuar.
- Neni 15, pika 4, germa "c", "Miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës, kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera", pa plotësuar. Nuk është paraqitur miratimi i projektit të rritjes së fuqisë nga autoritetit kontraktues.
- Neni 15, pika 4, germa "d", "Ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi", plotësuar.
- Neni 15, pika 4, germa "e", "Të ketë plotësuar pagesat e rregullimit në ERE", plotësuar.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me nenin 15, pika 4, germa "c", do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 11, pika 1 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë Rej Energy sh.p.k., dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 120, datë 29.8.2012, me nr. 177, seria PV12K, për "Prodhimin e energjisë elektrike", nga HEC-et: Cemerica 1, me fuqi të instaluar 0.88 mw; Cemerica 2, me fuqi të instaluar 0.9 mw; Cemerica 3, me fuqi të instaluar 2.1 mw.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti